

# Ditari Natyrës

## Në këtë numër do të gjeni:

- **Efiçenca e energjisë në Parkun Themistokli Gërmenji, Korçë.**
- **Rritja Blu.**
- **Zona e Malit të Pashtrikut si Park Natyror.**
- **Përmirësimi i Praktikave të peshkimit në liqenin e Ulzës dhe Rëndësia e tyre.**
- **Fushatë ndërgjegjësuere mbi ndërtimin e hidrocentraleve**
- **Shkollat e Gjelbërta.**

## *Efiçenca e energjisë në parkun “Themistokli Gërmenji” Korçë*

Në kuadër të projektit “Efiçenca e Energjisë për sistemin e ndriçimit në Parkun Themistokli Gërmenji” në qytetin e Korçës, në ambientet e këtij parku u organizua një ceremoni inauguruese e projektit. Në ceremoni merrnin pjesë përfaqësues të Prefekturës dhe Bashkisë Korçë, përfaqësues të OJF-ve të qytetit të Korçës, nxënës të shkollave, etj.

Projekti “Efiçenca e Energjisë për sistemin e ndriçimit në Parkun Themistokli Gërmenji”, i cili financohet nga GEF dhe Bashkia Korçë, ka për qëllim jo vetëm të kontribuojë për efikasitetin e energjisë në vend duke instaluar teknologjinë më të re, atë të përdorimit të llapave LED, por të sigurojë qasje të re, të krijojë një model për t’u ndjekur edhe

për pjesë të tjera të ndriçimit publik. Përdorimi i llambave LED në ndriçimin publik është një mënyrë alternative që çon në reduktimin e konsumit të energjisë. Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, organizata zbatuese e projektit në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës do të bëjnë të mundur instalimin e 20 shtyllave së bashku me ndriçuesit në një afat të shkurtër kohor.

Me anë të këtij projekti do të realizohet një investim direkt në përmirësimin e ndriçimit të parkut duke implementuar teknologjinë e re të instalimit të ndriçuesve LED. Zbatimi i një sistemi të ri ndriçimi në këtë park do të sigurojë një cilësi më të mirë dhe do të promovojë një mënyrë të re të mbrojtjes së natyrës me teknologji miqësore ndaj mjedisit. Llambat LED që do të përdoren në këtë projekt do të reduktojnë konsumin e energjisë dhe emisionet e CO2 në atmosferë duke krijuar një mjedis miqësor dhe më të shëndetshëm.



## *Rritja Blu*

Në kuadër të projektit EUSAIR, në Belgjikë u zhvillua Seminari “Rritja Blu – drejt një Plani Veprimi për Strategjinë e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit”, e njohur me shkurtimin EUSAIR (European Union Strategy for Adriatic and Ionian Region) në të cilin mori pjesë edhe përfaqësuesi i INCA-s, Z. Zamir Dedej.

Ai ishte pjesë e panelit për Planifikimin hapësinor dhe menaxhimi i zonës bregdetare. Në ndërhyrjen e tij ai diskutoi për dhënien e një sensi me praktik këtyre strategjive duke identifikuar më shumë masa që kanë impakt në terren. Duke parë agresivitetin e

ndërhyrjeve të njeriut në këtë zonë, veçanërisht në vitet e fundit ku po ndihet kriza ekonomike, kërkohen aktivitete konkrete në terren ku të përfshihen konceptet dhe mësimet e nxjerra nga vendet e zhvilluara. Si përfundim u pranua kërkesa për të mbështetur shtimin e zonave të mbrojtura detare dhe përmirësuar menaxhimi i tyre. Gjithashtu u ra dakord që Shqipëria ka nevojë për një Plan të Integruar për Menaxhimin e Zonës Bregdetare, duke përfutur nga eksperiencia e vendeve të rajonit e veçanërisht nga ajo e Malit të Zi që ka aprovuar dhe po zbaton së fundmi një plan të tillë.

## *Mali i Pashtrikut si Park Natyror*

Në kuadër të projektit SENiOR-A (Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri), më 22 Nëntor 2013, organizata Mbrojtja e Mjedisit, Kukës, organizoi takimin me temë “Zona e Malit të Pashtrikut si Park Natyror”.

Ky takim kishte si qëllim informimin e stafit të



DSHP Has, pushtetin vendor dhe OJF-të e zonës mbi procesin e shpalljes së malit të Pashtrikut, zonë më një status të veçantë, e cila është aktualisht në proces.

Në këtë takim një vëmendje e veçantë iu kushtua

konceptit të zonave të mbrojtura, klasifikimi sipas IUCN dhe rëndësia e tyre, me drejtim të veçantë mbi parkun natyror dhe përfitimeve që sjell ky status për banorët.

Gjerësisht u diskutua mbi Biodiversitetin në Malin e Pashtrikut si një pasuri e madhe e trashëgimisë natyrore ku një vëmendje e veçantë ju dha pasqyrimin dhe njohjes të specieve të rralla të florës dhe faunës së zonës si dhe problemeve me gjuetinë e paligjshme.

Nga të pranishmit gjatë diskutimeve u dhanë mendime me vlerë si për kufijtë e shtrirjes së parkut ashtu edhe për objekte me vlera të veçanta brenda zonës, si shpellat, peisazhin karstik të Cahanit, informacion mbi gjitarët e mëdhenj etj.

Në fund të takimit pati konsensus të plotë se zona paraqet vlera të rëndësishme përse i përket peisazhit, diversitetit të larmishëm biologjik dhe fenomeneve karstike si dhe ideja e shpalljes së zonës park natyror u përkrah nga të gjithë pjesëmarrësit.

## ***Përmirësimi i Praktikave të Peshkimit në Liqenin e Ulzës dhe Rëndësia e tyre***

Në kuadër të projektit SENiOR-A (Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri), Organizata "Miqësia" Ulzë, si pjesë e rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, organizoi më datë 26/11/2013 në qytezën e Ulzës, takim me temë "Përmirësimi i Praktikave të Peshkimit në Liqenin e Ulzës dhe Rëndësia e tyre".

Në takim morën pjesë përfaqësues të qeverisjes vendore, përfaqësues të INCA, përfaqësues të Federatës së Peshkimit të Ujërave të Ëmbla, përfaqësues të Universitetit Bujqësor, përfaqësues të inspektoratit të peshkimit të zonës, përfaqësues të Komunave Ulës dhe Kthellë, anëtarë të Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Ulzë, peshkatarë të zonës si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në takim u prezantua Strategjia dhe Plani i Veprimit për Përmirësimin e Situatës së Peshkimit në Liqenin e Ulzës, Manuali i Peshkimit për këtë Liqen si dhe u theksuan hapat konkret që duhen ndjekur për pranimin me të drejta të plota të OMP-së Ulzës në

Federatën e Ujërave të Ëmbla.



Në takim u diskutua mbi situatën e peshkimit, menaxhimin e gjuetisë së paligjshme në këtë liqen si dhe mbi bashkëpunimin me shoqatën e peshkatarëve dhe të mbarë shoqërisë civile në parandalimin e këtij fenomeni në të mirë të gjithë komunitetit. Gjatë diskutimeve doli në pah domosdoshmëria e forcimit të organizatës së peshkatarëve, bashkëpunimi me pushtetin lokal dhe strukturat shtetërore në përmirësimin e situatës së peshkimit.

## ***Fushatë ndërgjegjësuëse mbi ndërtimin e hidrocentraleve të planifikuara në lumin Devoll dhe Osum***

Përgjatë muajve Maj-Nëntor 2013 pesë OJF mjedisore në Shqipëri, EDEN, Ekolëvizja, INCA, PPNEA dhe Natyra Berat, me mbështetjen e WWF kanë përfunduar projektin me titull "Fushatë ndërgjegjësuëse mbi ndërtimin e hidrocentraleve të planifikuara në lumin Devoll dhe Osum".

Qëllimi kryesor i projektit ishte që të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe aktorëve të tjerë rreth efekteve dëmtoese që mund të sjellë ndërtimi i hidrocentraleve të shumta në Shqipëri. Një vend të veçantë zunë aktivitetet ndërgjegjësuëse me

komunitetin që jeton përreth Kanioneve të Osumit në Çorovodë me qëllim ruajtjen e vlerave të rralla natyrore të zonës që janë të pa zëvendësueshme për vendin tonë si dhe realizimi i pyetësorëve në tre rrethe të ndryshme nëpër të cilët kalon lumi i Devollit mbi të cilin janë planifikuar tre hidrocentrale. Qëllimi i realizimit të këtyre pyetësorëve ishte gjetja e shkallës së përfshirjes së komunitetit në vendimmarrje për vepra të tilla në vendin ku ata jetojnë.



## Shkollat e gjelbërta

Në kuadër të projektit për Shkollat e Gjelbërta të programit të minigranteve mbështetur nga Kompania e telefonisë AMC si dhe UNICEF, në fillim të muajit

N ë n t o r  
përfunduan  
zbatimin e  
tyre të gjithë  
miniprojektet  
e shpallur  
fitues.



Miniprojektet filluan me implementimin e tyre në muajin Maj 2013 dhe për një periudhë 6 mujore u realizuan të gjitha objektivat e vena për këtë qellim. Nga investimi i përbashkët mundësuar nga UNICEF dhe AMC, në ambientet e shkollave mësuesit fitues, në bashkëpunim me nxënësit e vetë shkollës,

realizuan punë konkrete si; rregullimi i sipërfaqeve të gjelbërta, pastrimi dhe rregullimi i oborrit të shkollës dhe ambienteve rreth tij, ngritje lulishtesh, vendosje stolash, zëvendësimi i tabelave ekzistuese me shkumës, realizimi i



dramatizimeve dhe festimi i ditëve të shënuara të mjedisit, realizimi i pikturave murale etj.

## NJOFTIME

1- WWF opens a content for Prince Bernard Scholarships for Nature Conservation. You can find more about the content on [http://wwf.panda.org/how\\_you\\_can\\_help/volunteer/prince\\_bernard\\_scholarships/](http://wwf.panda.org/how_you_can_help/volunteer/prince_bernard_scholarships/). Please send your application till 11/01/2014 on [ikorn@wwf.panda.org](mailto:ikorn@wwf.panda.org) and write Prince Bernard Scholar ships 2014.

2- The European Topic Centre on Biological Diversity (ETC/BD) is seeking a 'Nature Directives Officer', for its office in Paris. The post starts in January 2014. For further details, please see the announcement in English and in French. Please circulate the information within your networks. <http://bd.eionet.europa.eu>

## Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

• *Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në buletin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes buletinit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.*

*Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!*

• *Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.*

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës  
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro